



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2020:166420

Datë: 01.11.2021

Numri i dokumentit: 02342208

P.nr.1015/2020

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - Departamenti i Përgjithshëm përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Rilind Sermaxhaj, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Eronita Llapashtica, në çështjen penale ndaj të akuzuarve G. H dhe A.H që të dy nga fshati ..., Komuna e Gjilanit për shkak të veprës penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm me numër PP.II.nr.2041/2020 të datës 21.12.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, me datë 11.10.2021 mori dhe shpalli ndërsa me datë 01.11.2021 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

1. G. H nga babai S...dhe nëna B... e lindur B..., i lindur me datë ... në Gjilan ndërsa me vendbanim në fshatin ....., Komuna e Gjilanit, ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, i punësuar tek automekanik "Xahi" në fshatin Cërnice, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës dhe
2. A. H nga babi F... dhe nëna M...e lindur J...i lindur me datë ..., në Norvegji ndërsa me vendbanim fshatin ..., Komuna e Gjilanit, ka të kryer shkollën e mesme, i pamartuar, i punësuar si shofer tek automekaniku "Faruku" në fshatin ..., Komuna e Gjilanit, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

## JANË FAJTOR

Sepse me datë 28.11.2020, në intervalin kohor 22:00-22:50 minuta në Gjilan, i akuzuari A. H me forcë mekanike përkatësisht me veturën e markës “Tauran”, me tabela të regjistrimit ..., ngjyrë hiri, pronë e të akuzuarit G. H ka shkaktuar rrezik të madh për jetën e njerëzve në atë mënyrë që derisa zyrtarët policor të NJRSH B. M, F. K, I. R dhe E. G ishin në krye të detyrës në rrugën “15 Qershori” në Gjilan vërejnë veturën e markës “Tauran” me tabela të regjistrimit ..., ngjyrë hiri duke ardhur në drejtim të tyre me ç’rast me dritën rotative e sinjalizojnë të ndalet por i akuzuari i lartcekur nuk ndalet dhe zhvillon një shpejtësi shumë të madhe dhe iu ik zyrtarëve policor ndërsa më pas shkon në fshatin ... ku i tregon të akuzuarit G. H për veprimet e tij dhe duke u pajtuar edhe i akuzuari G... së bashku nisen prapë në drejtim të fshatit ... dhe me të arritur tek lagjja “e Muhaxherëve”, në momentin që i vërejnë policinë të cilët i sinjalizojnë me dritë rotative, të akuzuarit nuk ndalen por me një shpejtësi tejet të madhe nisen në drejtim të zyrtarëve policor të cilët ia kishin ngushtuar rrugën aq sa i dëmtuari E. G ka qenë i detyruar të hedhet nga rruga duke kërcyer për ti ikur goditjes ndërsa të akuzuarit ikin në drejtim të panjohur.

-Me çka kanë kryer veprën penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës,

Andaj gjykata në bazë të neneve 4, 38, 39, 40, 42, 43, 44, 69 dhe 70 të KPRK-ës dhe neneve 359, 360, 361, 362 dhe 365 të KPP-ës të akuzuarit e lartcekur:

## I GJYKON

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej nga 180 (njëqindetëtdhjetë) ditësh për secilin prej tyre veç e veç të cilat dënime në bazë të nenit 44 dhe pëlqimin e të akuzuarve ZËVËNDËSOHEN në dënime me gjobë në shumë prej nga 1500 € (njëmijepesëqind euro) për secilin prej tyre veç e veç dhe të cilat dënime të akuzuarit obligohen ti paguajnë në afat prej 15 ditësh nga dita kur ky aktgjykim të merr formë.

Nëse të akuzuarit nuk dëshirojnë, nuk mundën ose nuk janë në gjendje ti paguajnë dënimet me gjobë atëherë dënimet me gjobë secilit prej tyre veç e veç do t’iu zëvendësohen në dënime me burgim në atë mënyrë që për çdo 20 € (njëzet euro) do t’iu caktohet nga një ditë burgim.

Në bazë të nenit 79 të KPRK-ës të akuzuarit G. H koha e kaluar nën masën e arrestit shtëpiak nga data 28.11.2020 deri me datë e deri me datë 28.12.2020 do ti llogaritet në dënimin e shqiptuar me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Të dëmtuarit E. G, F K, I R dhe B. M për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.

Obligohen të akuzuarit e lartcekur që secili prej tyre veç e veç të paguajnë paushallin gjyqësor në shumë prej nga 50 € (pesëdhjetë euro) dhe shumën prej nga 30 € (tridhjetë euro) për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto brenda afatit prej 15 ditëve nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë nën kërcenim të përmbarimit të dhunshëm.

## ARSYETIM

### 1.Rrjedha e çështjes dhe fjalët përfundimtare të palëve

Prokuroria Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm me datë 21.12.2020 ka ngritur aktakuzën me numër PP.II.nr.2041/2020 kundër të akuzuarve G. H dhe A.H që të dy nga fshati ..., Komuna e Gjilanit për shkak të veprës penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës.

Me krijimin e kushteve ligjore gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit gjyqësor ku është bërë administrimi i provave personale dhe materiale si dhe palët kanë dhënë fjalët e tyre përfundimtare.

Prokurori i shtetit në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se pas administrimit të provave materiale, dëgjimit të dëmtuarve në cilësinë e dëshmitarëve si dhe dëgjimit të vetë të akuzuarve është vërtetuar se të akuzuarit G. H dhe A. H ishin kryerës të veprës penale të përshkruar si në dispozitivin e këtij akti akuzues, se është kryer kjo vepër nga këta dy të akuzuar më së miri është vërtetuar nga vet deklarimi i të akuzuarit A. H i cili i ka pranuar veprimet e tij inkriminuese si në rastin e pare po ashtu edhe në rastin e dyte të ikjes nga policia në ditën kritike por për ti ikur përgjegjësisë penale nuk e pranon të ketë rrezikuar policët dhe në gjykatore kanë dëshmuar vet të dëmtuarit B. M, F.K, E. G dhe I.R të cilët kishin qenë prezent ne ditën kritike dhe kohën kritike kur ka ndodhur ngjarja si në rastin e pare po ashtu edhe në të dytin, të njëjtit e kanë përshkruar veturën duke identifikuar targa e regjistrimit, kurse në rastin e dytë kishin qenë të rrezikuar ku i kishin paralajmëruar të ndaleshin por ata sapo i kishin parë policinë kishin rritur shpejtësinë dhe me i rrezikuari kishte qenë zyrtari policor E. G që mos ishte shmangur do të kishte pësuar goditje nga vetura sepse distanca ishte shume e shkurtër dhe vetura kishte qenë në shpejtësi te madhe, vet të akuzuarit A. H dhe G.H e kishin pohuar se nuk janë ndalur, ku i akuzuari G. H kishte qene ne dijeni se A.H nuk iu kishte ndalur policëve as herën e parë, ku i akuzuari

A. H i kishte treguar edhe atyre në vilë që ishin te pranishëm ndërsa i akuzuari G... si pronar dhe prap ia lejon që A. H ta vozis veturën e tij dhe në moment kritik për herë të dytë kur e kishin pare policinë i akuzuari A. H kishte marrë miratimin edhe të akuzuarit G. H për arsye se vetura nuk ishte e tij për t'ju ikur policisë, i njëjti i akuzuari G... ia pohon eh qe kjo ishte ndërlidh me deklaratën e te akuzuarit G... i cili kishte pohuar qe ne ikëm pasi qe frikësoheshim se do te na rrihnin policia, kurse deklarimet e te tjerëve dëshmitar si: N. A, P.Z dhe K. H i dha mbështetje kjo gjendje faktike, kurse deklarata se kishin parë atë natë duke vozitur veturën të akuzuarin G... hoxhën mbetet e vështir për te besuar duke marr parasysh rrethanat si qeshte përshkruar ngjarja se vetura ishte ne nje shpejtësi te madhe , dhe se ishte nate dhe duke pas po ashtu parasysh se dallimi mes dy te akuzuarve nuk është i theksuar shume, i njëjti ka deklaruar se mbetet pran aktit akuzues dhe kërkon që të akuzuarit të shpallen fajtor dhe të dënohen sipas ligjit.

Mbrojtësi i të akuzuarit G. H, avokati V. K nga ...në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se me asnjë provë të vetme nuk është provuar se i akuzuari G. H ka kryer vepër penale shkaktim i rrezikut te përgjithshëm nga neni 356 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-se dhe se aktakuza e Prokurorisë Themelore ne Gjilan sa i përket të akuzuarit G.H është e paqëndrueshme dhe e mangët meqenëse në dispozitivin e saj nuk janë përshkruar veprimet inkriminuese të akuzuarit G. H të cilat do ta kishin formësuar veprën penale për të cilën akuzohet i njëjti dhe nëse analizohet përmbajtja e dispozitivit të aktakuzës nuk mund të vërtetohet se cilat veprime i ka ndërmarrë i akuzuari G. H për ti rrezikuar policinë meqenëse i njëjti nuk e ka drejtuar veturën “Tauran” në asnjë moment, më tutje i mbrojtësi i të akuzuarit G...ka shtuar se nëse analizohet neni 356 paragrafi 1 i KPRK-së parashihet se kushdo që me anë të zjarrit, vërshimeve, armëve, eksplozivit apo ndonjë mjeti tjetër vdekjeprurës, helmin, ose gazin helmues, rrezatimit jonizues, forcë mekanike, me energji eklektike ose me ndonjë lloj energjie tjetër ose me ndonjë veprim tjetër të rrezikshëm apo mjete të rrezikshme shkakton rrezik të madh për jetën e njerëzve apo dëm të konsiderueshëm pasuror, pra kushdo që i kryen veprimet e përmendura është kryerës i kësaj vepre penale ndërsa në rastin konkret i akuzuari G. H nuk kishte ndërmarr asnjë veprim të vetëm të rrezikshëm me të cilin do ti rrezikonte policinë apo pjesëmarrësit tjerë në trafik meqenëse edhe sipas prokurorisë i njëjti nuk e ka drejtuar në mbrëmjen kritike në asnjë moment veturën “Tauran”.

I akuzuari G. H në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështetë në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij dhe se nuk ka se çfarë të shtoj tjetër.

I akuzuari A.H në fjalën përfundimtare ka deklaruar se kërkon nga gjykata një dënim sa më të lehtë, kjo ishte ë hera e parë që bie ndesh me ligjin dhe se më parë nuk ka qenë i gjykuar për ndonjë vepër penale dhe se nuk ka se çfarë të shtojë tjetër përveç se e ndjen vetën fajtor siç ka deklaruar edhe më herët për këtë vepër penale.

## 2.Provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor

Gjykata pas administrimit të provave personale dhe materiale plotësisht ka vërtetuar gjendjen faktike si në dispozitiv të aktgjykimit dhe atë në bazë të:

- Dëgjimit të dëmtuarit në cilësinë e dëshmitarit B. M
- Dëgjimit të dëmtuarit në cilësinë e dëshmitarit F.K
- Dëgjimit të dëmtuarit në cilësinë e dëshmitarit E. G
- Dëgjimit të dëmtuarit në cilësinë e dëshmitarit I. R.
- Dëgjimit të dëshmitarit K. H
- Dëgjimit të dëshmitarit N.A
- Dëgjimit të dëshmitarit P. Z
- Leximin dhe administrimin e provave materiale si: raporti fillestar i incidentit me numër të rastit ... i datës 28.11.2020, alkool testin e matur për të akuzuarin G. H, raportet e oficerëve të datës 28.11.2020 dhe 29.11.2020, deklaratat e të dëmtuarave F. K, E. G dhe B.M të dhëna në prokurori me datë 07.12.2020 dhe 14.12.2020, deklarata e dëshmitarit K. H e dhënë në prokurori me datë 18.12.2020, deklaratat e të akuzuarve A. H dhe G. H të dhëna në prokurori me datë 11.12.2020 dhe 18.12.2020.
- Mbrojtja e të akuzuarit G. H dhe
- Mbrojtja e të akuzuarit A.H

### 2.1. Deklarata e të dëmtuarit F.K e dhënë në cilësinë e dëshmitarit.

I dëmtuari F. K në cilësinë e dëshmitarit në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se është e vërtet se ka përpiluar raport të oficerit si dhe ka dhënë deklaratë lidhur me këtë çështje në prokurori duke shtuar se ka kaluar një kohë dhe mundë të i ik ndonjë detaj, në natën kritike kanë qenë duke patrulluar në qytet dhe të angazhuar në planin operativ Covid 19 dhe të orës policore dhe rasti kur ka ndodhur ka qenë ore policore dhe ka pasur kufizim të lëvizjes, afër furrës “Aroma” diku në përball kalimin prej rrugës se Prishtinës në drejtim të lagjes “Dardania” kishte qenë duke ardhur një veturë të cilën e kishin sinjalizuar me dritë rotative që të ndalet, vetura në fakt kur ishte ofruar afër tyre e kishte rrit shpejtësinë e lëvizjes dhe nuk u ishte bindur urdhrave për tu ndaluar, në momentin e pare nuk kishte shkaktuar ndonjë rrezik tek ta sepse ata nuk ishin jashtë veturës por në veturë, e kishte parë se në pjesën e shoferit ka qenë ulur G. H, me ç’rast kishin arritur me i marr targat e regjistrimit te veturës dhe e kishin identifikuar se vetura është e G. H por nuk e din se e ka pasur persona të tjerë në veturë pasi ka qenë i fokusuar vetëm tek shoferi, veturës i ishin vënë pas por i njejt i në një pjesë të lagjes “Dardania” u kishte

humbur nga shikimi meqenëse kishte zhvilluar një shpejtësi të madhe dhe të rrezikshme, më pas veturën e kishin identifikuar dhe ishin nisur në drejtim të fshatit ... ndërsa herën e dyte diku pas 40 minutave tek pjesa e Muhaxherëve të Livoçit e kishin vërejtur që është duke ardhë nje veturë nga fshati Cërnice në drejtim të fshatit Livoq dhe kishin filluar t'ia ngushtojnë rrugën dhe e kishin sinjalizuar me dritë rotative që të ndal ndërsa veturën e tyre e kishin ndal dhe nga vetura kishte dal së bashku me të dëmtuarin E... dhe e kishin sinjalizuar veturën që vinte në drejtim të tyre me bateri të dorës që të ndalej mirëpo kur kjo veturë ishte ofruar ajo e kishte rritur shpejtësinë dhe e kishte rrezikuar të dëmtuarin E... drejtpërdrejtë dhe kishin vërejtur se vetura është e njëjta me herën e parë e po ashtu edhe shoferi ishte i njëjti person por se nuk mund të thotë se a ka pasur ndonjë person tjetër në veturë më pas e kishin kthyer veturën dhe u ishin vënë në ndjekje sërish veturës së markës “Tauran” por sërish i njëjti u kishte humbur në pamje dhe më pas nga aty kishin vazhduar për në fshatin ... Komuna e Gjilanit dhe kishin arritur ta gjejnë shtëpinë e G. H dhe të sigurojmë numrin e telefonit të tij të cilin e kishte thirr personalisht dhe i kishte treguar se ishin duke e pritur para shtëpisë së tij dhe pas disa minutave kishte ardhur G...me veturën “Tauran” të cilin më pas e kanë arrestuar dhe e kanë dërguar në stacionin policor në Gjilan për procedura të mëtutjeshme.

## 2.2 Deklarata e të dëmtuarit E.G e dhënë në cilësinë e dëshmitarit.

I dëmtuari E.G në cilësinë e dëshmitarit në seancë e shqyrtimit gjyqësor kishte deklaruar se lidhur me këtë rast ai ka përpiluar raport të oficerit si dhe ka dhënë deklaratë në pranë të cilave edhe mbetet, fillimisht me të dëmtuarit e tjerë ka qenë në rrugën “15 Qershori” dhe në atë kohe ka qenë e ndaluar lëvizja e lire e qytetarëve, ekipi tyre që përfshinë I. R, F. K dhe B M kishin vërejtur një veturë që vinte në drejtimin e tyre të cilën e kishin sinjalizuar me dritë rotative për të ndalur por vetura nuk ishte ndalur dhe kishte vazhduar rrugën përkatësisht të ikte, ai ka qenë i ulur në veturën e policisë prapa shoferi, ai nuk ka mundur ta vërej se kush ka qenë në atë veturë dhe sa veta kanë qenë, pasi vetura nuk ishte ndaluar të dëmtuarit janë kthyer për ti ndjekur por vetura që nuk ishte ndaluar kishte zhvilluar një shpejtësi të madhe dhe të rrezikshme me ç’rast edhe u ishin shmangur të dëmtuarëve pastaj të njëjtit-të dëmtuarit kanë vazhduar patrullimin ka lagjja e 8-të tek ferma e pulave në fshatin Livoq dhe gjatë patrullimit kishin hasur një veturë që vinte në drejtim të tyrin, të cilën e kishin sinjalizuar me drite rotative për tu ndalur ndërsa me veturën e tyre ia kishin ngushtuar rrugën duke ia lënë vetëm një shteg të lirë për të kaluar vetura tjetër më pas ai kishte zbritur nga vetura dhe me dritën e dorës e kishte sinjalizuar veturën tjetër të ndalet mirëpo kjo veturë nuk ishte ndaluar sepse kur u ishte ofruar veturës së të dëmtuarve e kishte rritur shpejtësinë aq sa i dëmtuari E...është detyruar të largohet nga rruga pasi që kishte rrezik për tu goditur nga vetura tjetër dhe po të qëndronte aty do të goditej nga kjo veturë dhe në ato momente e kishte vërejt se në veturë kishte edhe persona të tjerë përpos shoferit por nuk ka mundur ti identifikoj të njëjtit më pas e kanë identifikuar veturën përmes targave të tij dhe ka rezultuar se është e G.H nga fshati ..., Komuna e Gjilanit dhe më pas kanë shkuar tek shtëpia e tij, kanë kontaktuar me

babain e të akuzuarit G... e cili e kishte thirre në telefon të akuzuarin G... dhe pas pak ai kishte ardhur dhe pastaj të njëjtit kanë vazhduar me procedurën e mëtutjeshme të policisë.

### 2.3. Deklarata e të dëmtuarit I. R e dhënë në cilësinë e dëshmitarit.

I dëmtuari I. R në cilësinë e dëshmitarit në seancë e shqyrtimit gjyqësor kishte deklaruar natën kritike kishte qenë vozitës i veturës zyrtare së bashku me dëmtuarit e tjerë, atë natë kishte qenë orë policor dhe ata kishin pasur për obligim për ti ndalur dhe verifikuar të gjitha veturat, tek “Durrësi” rruga “15 Qershori” e kishin parë një veturë duke ardhur nga rrethi i rrugës së “Prishtinës” te poshtë të cilën e kishin sinjalizuar për tu ndalur duke i përdorur dritat rotative dhe dritat e veturës, vetura i kishte vërejtur e cila ishte duke zhvilluar një shpejtësi normale fillimisht por kur ishin ofruar kishte rritur shpejtësinë dhe i kishte përball kaluar, ai ishte i fokusuar tek shoferi dhe të njëjtin e kishte identifikuar dhe ai ishte i akuzuari G. H, të njëjtin e ka identifikuar për faktin se vetura e të dëmtuarve i kishte dritat e ndezura dhe distanca e përball kalimit ka qenë 1-2 metra por nuk e di se a ka pasur persona të tjerë në veturë pasi që ka qenë i fokusuar vetëm tek shoferi. Vetura tjetër kishte zhvilluar shpejtësi të madhe, të pa kontrolluar dhe të pa përshtatshme për kushtet e rrugës dhe më pas kishte vazhduar për në rrugën “...” ku edhe u kishte humbur nga shikimi por ata kishin arritur që ti merrnin targat e saj dhe më pas kishin bërë identifikimin e veturës dhe kishte rezultuar se pronar është i akuzuari G. H, pas identifikimit kanë vazhduar për të shkuar tek shtëpia e të G. H dhe kur mes fshatit ... dhe fshatit Cërnice kishin parë një veturë që vinte në drejtimin e tyre dhe kishin vërejtur se ishte vetura që u kishte ikur më herët dhe në ato momente ajo veturë e kishte rritur shpejtësinë e lëvizjes ndërsa nga vetura e të dëmtuarve kishin dal të dëmtuarit dal F. K dhe E. G të cilët e kishin sinjalizuar veturën tjetër edhe me bateri të dorës ndërsa ajo veturë ishte e sinjalizuar edhe me dritë rotative, ajo veturë ishte nisur në drejtim të zyrtarit E.G i cili ishte në rrugë për ta ndalur veturën tjetër e cila ishte në shiritin e saj dhe pas këtyre sinjalizimeve vetura e të akuzuarve vetëm e kishte rritur shpejtësinë dhe me dashje e ka rrezikuar drejtpërdrejt E. G ndërsa E... kishte kërcyer prej rrugës ka vetura e policisë të cilën e ka shfrytëzuar si mburojë nga aksidenti dhe se nëse i njëjti nuk do të largohej ajo veture do ta kishte shkelur sepse ka qenë tendenca e shoferit të mos ndalet, dhe në momentin e përball kalimit kishin vërejtur se ishte G. H sërish por nuk e di se a ka pasur persona të tjerë në veturë më pas të dëmtuarit-policia kishte shkuar tek shtëpia e të akuzuarit G.H ku kishin takuar prindin e tij dhe pas kontaktit telefonik i njëjti pas 30 minutave kishte ardhur aty me të njëjtën veturë që u kishte ikur i cili më pas është arrestuar dhe është vazhduar me procedurat e mëtutjeshme të policisë.

### 2.4. Deklarata e të dëmtuarit B.M e dhënë në cilësinë e dëshmitarit.

I dëmtuari B. M në cilësinë e dëshmitarit B. M në seancë e shqyrtimit gjyqësor kishte deklaruar se natën kritike kishin qenë në detyrë me F. K, I.R dhe E G, kishin qenë duke patrulluar në lagjen e “Gavranit” dhe tek rruga përball çerdhes në këtë lagje – tek rruga e “Durrësit” e kishin parë një veturë që vinte në drejtim të tyre te poshtë me një shpejtësi të madhe në përball kalim ndërsa Ibrahimimi i cili kishte qenë shofer i veturës së policisë ia kishte ndezur rotacionin për tu ndalur vetura por e njëjta nuk ishte ndalur dhe deri sa e kishin arrit që ta kthejnë veturën vetura e të akuzuarve ishte larguar dhe kishin të njëjtit kishin vazhduar për ta kërkuar por ajo veturë u kishte ikur me ç’ rast përmes motorollës janë njoftuar se është bërë identifikimi i veturës përmes targave të regjistrimit dhe cilit person i takon kjo veturë, pas këtij njoftimi të njëjtit kanë vazhduar në drejtim të fshatit ... dhe tek ferma e pulave - lagjja e Muhaxhirëve e kishin parë se po një veturë po vinte në drejtimin e tyre dhe duke u ofruar e kanë vërejtur se ishte e njëjta veturë me të njëjta targa të regjistrimit, të njëjtën e kishin sinjalizuar dhe kishin menduar se vetura do të ndalej, vetura njëherë e kishte zvogëluar shpejtësinë dhe më pas E... kishte dal nga vetura dhe se i akuzuari si e ka parë që i njëjti ka dalë nga vetura e kishte rritur shpejtësinë por fati i E... që nuk ishte goditur nga vetura dhe më pas kjo veturë sërish u kishte ikur ndërsa të dëmtuarit duke e ditur që pronari i veturës ishte nga fshatit ... kishin shkuar në këtë fshat dhe e kishin gjetur shtëpinë e pronarit të veturës dhe e kishin takuar prindin e tij i cili i kishte telefonuar pronarit e veturës përkatësisht të akuzuarin G... i cili kishte ardhur i vetëm dhe më pas të njëjtin e kishin arrestuar dhe kishin vazhduar me procedurat e rregullta të policisë.

#### 2.5.Deklarata e dëshmitarit K. H

Dëshmitari K. H ne seancë e shqyrtimit gjyqësor kishte deklaruar: se natën kritike herën e parë kishte dalë me A. H në qytet për të blerë bukë me veturën e G.H, kur kishin arritur tek rruga “te Durrësi” aty kishin qenë policia të cilët nuk i kujtohet nëse kanë sinjalizuar dhe më pas kishin kaluar pranë tyre, kishin hyrë në një rrugë në të majtë dhe kishin dalë tek rruga “e Prishtinës”- tek tuneli dhe nga aty kishin vazhduar në drejtim të fshatit Cërnice ku e kishin marrë të akuzuarin G. dhe pastaj ne të tre kemi dalë në Livoq dhe G...ka qenë i ulur prapa në veturë dhe sërish kur i kanë parë policën në fshatin Livoq derisa kanë qenë drejtë me policinë kanë vozitur normal, pastaj pasi që e kanë takuar policin e kanë rritur shpejtësinë, policisë nuk iu kanë ndalur pasi që kanë pasur frikë meqenëse ka qenë ora policore do të ndaloheshin dhe më pas nga aty janë ndalur në një rrugë në fshatin Livoq për mos tu parë nga ana e policisë të cilët e kanë ftuar G... në telefon i cili më pas ka shkuar ndërsa ai me A... kanë qëndruar në fshatin Livoq rrugës kryesore,

#### 2.6.Deklarata e dëshmitarit P.Z.



Dëshmitari P. Z ne seancë e shqyrtimit gjyqësor kishte deklaruar: se natën kritike kur e kishte përfunduar brifingun e punës në ora 22:45 -23:00 h njësitë i reagimit të shpejt i kishte sjellë të akuzuarin në stacionin policor dhe kur e kishte pyetur të dëmtuarit se çfarë ka ndodh ata kishin deklaruar se i akuzuari nuk është ndalë në shenjat e policisë dhe më pas ka kërkuar nga zyrtarët e NJRSH-së- të dëmtuarit që të përpilojnë raport me shkrim lidhur me ngjarjen dhe pasi që ka marrë informatat e duhura ka caktuar zyrtarin policor N. A që të merret me rastin dhe se asgjë tjetër nuk ka lidhje me rastin.

#### 2.7.Deklarata e dëshmitarit N. A

Dëshmitari N. A ne seancë e shqyrtimit gjyqësor kishte deklaruar se natën kritike pas pranimit të ndërrimit nga shefi i ndërrimit P. Z i është dhënë një raport i policëve të NJSH-së dhe vendimi për ndalim i lëshuar nga prokurori i shtetit, natën kritike në stacion ka qenë vetëm njëri nga të akuzuarit mirëpo nuk iu është kujtuar se cili prej tyre sepse kishte pasur edhe raste të tjera, më pas të arrestuarit ia kanë siguruar avokatin mbrojtës dhe i njëjti është intervistuar dhe ka deklaruar lidhur me ngjarjen ku kishte thënë se ai nuk ka qenë shofer i automjetit dhe më pas ka përgatitur rastin dhe se nuk ka të shtoj diçka tjetër me rastin sepse nuk kishte qenë dëshmitar okular.

#### 2.8.Mbrojtja e të akuzuarit G. H.

I akuzuari G. H në mbrojtjen e tij të dhënë në shqyrtim gjyqësor ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë deklaratës së dhënë para prokurorit të shtetit duke shtuar se herën e parë kur A. Hi ka ikur policisë ai nuk ka qenë në veturë me të dhe K. H ndërsa herën e dytë ka qenë me ta i ulur në cilësinë e pasagjerit ku kishin dalur për të blerë bukë në fshatin Livoq dhe tek Muhaxherët e kishin takuar policin të cilëve nuk u janë ndalur, shofer ishte A.H i cili nuk është ndal sepse kishte qenë ora policore dhe i njëjti i kishte ikur policës edhe në Gjilan për të cilën gjë nuk e kishte ditur, mirëpo kur kishin arritur tek Muhaxherët dhe kishin parë policinë në ato momente ata i kanë treguar se iu kanë ikur policës edhe në Gjilan, kur iu kishin afruar policisë afër 20 metra ata kishin ndezur dritën rotative dhe ishin duke lëvizur por të njëjti nuk kishin dal nga vetura dhe nuk kanë qenë të rrezikuar nga vetura e tyre por pasi që i kanë ikur policisë në telefon e kishte thirrur polici- dëmtuari F.K dhe i ishte prezantuar se ai ishte polici të cilit i kanë ikur, ndërsa ky i ishte përgjigjur se ai nuk i ka ikur por tjetër kush dhe pas rreth 10 minutave e kishte thirrur prindi i tij në telefon dhe i krihte thënë hajde se kanë ardhë policia dhe i njëjti kishte shkuar, ndërsa kur Andi i ka treguar se i kishte ikur policisë kishin qenë në veturë duke vozit por se nuk kishte bërë muhabet për këtë gjë sepse kanë qenë duke ikur nga policia dhe në ikje e sipër nuk ka kërkuar nga A... që të ndalet, distanca në mes veturës së tyre dhe të policisë herën e dytë ka qenë rreth një metër.

### 2.9.Mbrojtja e të akuzuarit A.H.

I akuzuari A. H në mbrojtjen e tij të dhënë në shqyrtim gjyqësor ka deklaruar: se natën kritike së bashku me dëshmitarin K. H kanë qenë në Gjilan për të blerë buke me veturën e markës ‘‘Tauran’’ të G...dhe kur janë afruar tek ‘‘Durrësi’’ ka vazhduar në drejtim të policës të cilët ishin aty për të njëjtëve nuk iu ishte ndalur ku ishte kthyer në rrugën e majtë dhe pasi që kishte kuptuar se çfarë ka bërë nuk kishte guxuar që të ndalet dhe kishte vazhduar për te vila ku ishin G...dhe disa shokë të tjerë të cilëve iu kishte treguar se çfarë ka bërë në Gjilan, meqenëse nuk kishin blerë bukë së bashku me K... dhe G...ishin kthyer për në fshatin Livoq dhe tek Muhaxherët e kishin parë një veturë dhe kur ishin afruar e kishte vërejtur se janë policia dhe i kishte thënë ‘‘a ikum’’ ndërsa G...dhe K... iu kishin thënë ‘‘ikum’’ dhe kanë vazhduar drejt në një oborr të një shtëpie ne fshatin Livoq ku më pas G... e kishte thirrur njëri nga policët dhe i kishte thënë që të shkoj tek shtëpia e G... ndërsa ai dhe K... rrugën e kishin bërë në këmbë, kur kanë shkuar tek vila G... ka qenë duke i pritur për tu kthyer në Livoq për të blerë bukë, i njëjti kishte hipur në veturë dhe në atë moment të akuzuarit G. ia kishte treguar ngjarjen ndërsa në herën e dytë meqenëse vetura nuk kishte qenë e tij kishte thënë ‘‘a ikum’’G. dhe K. iu ishin përgjigjur ‘‘ikum’’ dhe gjatë ikjes distanca në mes tyre ka qenë sa për të kaluar dy vetura dhe goma e djathtë e veturës së tyre ka qenë jashtë rrugës gjatë vozitjes me qëllim të mos ta rrezikoj dikë, sepse policia ishte drejtuar në rrugën e tyre me qëllim për tua zërë rrugën dhe për këtë arsye është dashur që të dal jashtë rrugës.

### 3. Vlerësimi dhe analizimi i provave.

Në seancat e shqyrtimit gjyqësor në këtë çështje penale gjykata komfor nenit 7 të KPP-së saktësisht dhe në mënyrë të plotë vërtetoi faktet që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm, me vëmendje dhe përkushtim maksimal profesional dhe me përkujdesje të njëjtë vërtetoi faktet kundër të akuzuarve dhe ato në favor të tyre duke i mundësuar të akuzuarve shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të mbrojtjes dhe me ndërgjegje vlerësoi çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera dhe në bazë të vlerësimit të tillë ka ardhur në përfundim se mbrojtjes së të akuzuarit A. H të dhënë në shqyrtim gjyqësor duhet ti falet besimi ngase e njëjta në harmoni edhe me provat e tjera personale dhe materiale të cilat janë administruar nga ana e gjykatës ndërsa mbrojtjes së të akuzuarit G. H nuk duhet ti falet besimi ngase e njëjta nuk është në harmoni me provat e tjera personale dhe materiale të administruara nga ana e gjykatës dhe të cilat tregojnë një gjendje faktike tjetër nga ajo për të cilën i njëjti ka pretenduar ndërsa në anën tjetër besimi duhet t’iu falet deklaratave të dëmtuarve F.K, E G, I.R, B. Mpërpos në pjesën e identifikimit të shoferit të veturës së markës ‘‘Tauran’’ dhe dëshmitarit K.H ndërsa deklaratat e dëshmitarëve N.A dhe P. Z për gjykatën nuk kishin ndonjë relevancë për faktin se të njëjtit vetëm kanë përshkruar veprimet hetimore të cilat i kanë marrë si oficer policor dhe të njëjti nuk ishin dëshmitar të ngjarjes.

Pas administrimit të provave personale dhe materiale gjykata gjeti se në këtë çështje penalo juridike nuk ishte kontestues fakti se i akuzuari A. H me datë 28.11.2020 në intervalin kohor 22:00-22:50 minuta në Gjilan duke e drejtuar veturën e markës “Tauran” me tabela të regjistrimit ... dhe në pronësi të akuzuarit G. H kishte bërë vozitje të rrezikshme me qëllim të ikjes nga ana e policisë përkatësisht të dëmtuarëve të cilit si zyrtar policor ishin në patrullim e sipër, nuk ishte konstatues as fakti se me të në veturë ishte edhe dëshmitari K.H, nuk ishte kontestues as fakti se të njëjtit pasi u kishin ikur policisë kishin shkuar në një vilë në fshatin Cërniceë, Komuna e Gjilani ku ishte duke qëndruar edhe i akuzuari G.H, nuk ishte kontestues as fakti se pasi që të njëjtit shkojnë tek kjo vilë aty jashtë i priste i akuzuari G... i cili kishte hipur në veturë së bashku me të lartcekurit sërish ishin nisur në drejtim të Gjilanit, nuk ishte kontestues as fakti se të akuzuarit kur kishin arritur tek lagjja e “Muhaxherëve” kishin parë të dëmtuarit-policinë dhe përkundër sinjalizimit të tyre si dhe faktit se të njëjtit edhe ua kishin ngushtuar rrugën të akuzuarit kishin zhvilluar një shpejtësi të madhe me qëllim për tu mos u ndalur aq sa i dëmtuari E.G i cili kishte zbritur nga vetura e policisë është dashur që të largohet nga rruga duke kërcyer për ti ikur goditjes nga vetura e ku ishin të akuzuarit pra shikuar në përgjithësi gjendja faktike e përshkruar si në dispozitiv të aktakuzës lëndore nuk ishte kontestuese ndërsa duke pasur parasysh faktet jo kontestuese gjykata gjeti se në këtë çështje penalo juridike kontestues ishte fakti se cili nga të akuzuarit ishte shoferi i veturës me të cilin është shkaktuar rreziku i përgjithshëm me ku edhe është rrezikuar jeta e të dëmtuarëve si dhe fakti nëse në veprimet e të akuzuarve ekziston apo jo bashkëkryerja në kryerjen e veprës penale por gjykata këto fakte kontestuese i zgjodhi duke u bazuar së pari në vet mbrojtjen e të akuzuarit A. H i cili në të gjitha statet e procedurës penale e ka pranuar edhe fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale duke shtuar se edhe herën e parë por edhe herën e dytë kur kanë ikur nga policia-të dëmtuarit shofer i veturës “Tauran” ka qenë vet ai, deklarim ky i cili gjën mbështetje edhe në deklaratën e dëshmitarit K. H i cili në të gjitha statet e procedurës penale po ashtu ka deklaruar se shofer i veturës si herën e parë ashtu edhe herën e dytë ka qenë i akuzuari A. H, gjithashtu një fakt i tillë është vërtetuar edhe nga vet mbrojtja e të akuzuarit G.H i cili ka deklaruar se herën e dytë ai ka qenë në veturën e markës “Tauran” në pronësi të tij mirëpo të njëjtën e ka drejtuar i akuzuari A.H derisa ai ka qenë i ulur prapa siç kishte deklaruar edhe dëshmitari K. H ndërsa deklaratave të dëmtuarëve lidhur me identifikimin e shoferit të veturës me të cilën është shkaktuar rreziku i përgjithshëm përkatësisht faktin se kush ishte shoferi në herën e parë e kush në herën e dytë gjykata nuk ua fali besimin në këtë pjesë për faktin se siç me të drejtë edhe prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare ka theksuar deklaratave të dëmtuarëve në këtë pjesë nuk duhet t’iu falet besimi ngase duke pasur parasysh rrethanat e çështjes, mënyrën e kryerjes së veprës penale, faktin se vetura ishte duke zhvilluar një shpejtësi të madhe, ishte natë dhe vendin e ngjarjes nuk kishte ndriçim si dhe faktin se dallimi mes të akuzuarve nuk është edhe aq i theksuar në aspektin fizik identifikimi i shoferit të veturës duket i vështirë ndërsa deri tek konstatimi se i akuzuari G. H ka qenë pjesëmarrës në kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet së bashku me të akuzuarin A. H dhe se i njëjti ka dhënë kontribut të rëndësishëm në kryerjen e saj erdhi së pari duke u bazuar në atë se për të ekzistuar bashkëkryerja është shumë e rëndësishme që mes kryesve të ekzistoj aspekti

*objektiv* i bashkëkryerjes përkatësisht fakti që secili nga pjesëmarrësit të ndërmerr ndonjë veprim në drejtim të kryerjes së veprës penale dhe aspekti *subjektiv* përkatësisht manifestimi i vullnetit të kryesve për ta kryer veprën penale çka në rastin konkret gjykata konsideron se në veprimet e të akuzuarit manifestohen si aspekti objektiv ashtu edhe ai subjektiv i bashkëkryerjes për faktin se sipas deklaratës së dëshmitarit K. H e po ashtu deklaratave të dëmtuarve si dhe vet mbrojtjes së të akuzuarve del se i akuzuari A.H pasi që herën e parë i kishte ikur policisë duke u kthyer në fshatin Cërnicë e kishte thirr në telefon të akuzuarin G...dhe i kishte treguar për ngjarjen e më pas kishte shkuar në fshatin Cërnicë, Komuna e Gjilanit, e kishte marrë të akuzuarin G...i cili ishte jashtë vilës duke i pritur dhe sërish ia kishte treguar ngjarjen edhe në veturë dhe pas gjitha këtyre të njëjtit vendosin të kthehen sërish në drejtim të Gjilanit duke e ditur se ka qenë kufizim i lëvizjes së qytetarëve dhe policia-të dëmtuarit mund ti kërkonin të njëjtit për shkak të veprimeve të akuzuarit A.H të bëra herën e parë kur u ka ikur policisë mirëpo përkundër gjitha këtyre të njëjti kur në herën e dytë i takojnë policinë-të dëmtuarit i akuzuari A.H si shofer i veturës ka kërkuar miratimin e të akuzuarit G. H si pronar i veturës duke iu drejtuar me fjalët “a ikim” dhe në këtë moment i akuzuari G si pronar i veturës i ishte përgjigjur “ikim” dhe rrjedhimisht duke u bazuar në të lartcekur gjykata erdhi në përfundim se në veprimet e të akuzuarve manifestohet aspekti objektiv dhe subjektiv i bashkëkryerjes ashtu siç përcaktohet me nenin 31 të KPRK-ës për faktin se i akuzuari G. H kishte njohuri se i akuzuari A. H me veturën e tij i kishte ikur policisë herën e parë dhe përkundër kësaj i njëjti kur takohet me të akuzuarin A. H dhe dëshmitarin K.H hip në veturë me ta dhe përkundër që kishte kufizim të qarkullimit për qytetarë ata nisen sërish në drejtim të qytetit të Gjilanit dhe kur takohen me të dëmtuarit si pronar i veturës ia kishte dhënë lejen (miratimin) të akuzuarit A. H për ti ikur policisë dhe me këtë rast gjatë vozitjes së veturës ishte shkaktuar rrezik për jetën e të dëmtuarëve.

#### 4.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata erdhi në përfundim se është vërtetuar plotësisht gjendja faktike si dhe është vërtetuar përtej çdo dyshimi të bazuar mirë se të akuzuarit A. H dhe G. H kanë kryer veprën penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivit të këtij aktgjykimi.

#### 5.Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka vlerësuar që të akuzuarve duhet ti shqiptohen dënimet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale, sjelljen dhe rrethanat e kryesve si dhe përgjegjësinë penale të tyre ashtu që me rastin e matjes së dënimit pati parasysh rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit si në kuptim të nenit 69 të KPRK-ës ku mori

parasysh shkallën e përgjegjesisë penale të kryesve e cila nga provat materiale të administruara në seancat e shqyrtimit gjyqësor del të jetë e lartë meqenëse të akuzuarit me rastin e kryerjes së veprave penale secili prej tyre kanë qenë të përgjegjshëm për veprimet e tyre dhe veprën penale e kanë kryer me dashje dhe atë direkte, po ashtu me rastin e caktimit të dënimit gjykata pati parasysh rrethanat në të cilat është kryer veprat penale, sjelljen e mëparshme të kryesve, rrethanat personale të tyre si dhe sjelljen e tyre pas kryerjes së veprës penale.

Me rastin e matjes së dënimit gjykata është bazuar edhe në rregullat e përgjithshme të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit si në kuptim të nenit 70 të KPRK-ës ashtu që si rrethana lehtësuese për të akuzuarit mori rrethanat personale të tyre për faktin se për njëjtë kjo ishte hera e parë që bien ndesh me ligjin përkatësisht më parë të njëjtë nuk kanë qenë të gjykuar e as dënuar me ndonjë aktgjykim të formës së prerë për çfarëdo vepre penale, pastaj bashkëpunimin e përgjithshëm me organet e ndjekjes si dhe sjelljen e tyre pas kryerjes së veprës penale meqenëse të njëjti pas këtij rasti nuk kanë rënë ndesh me ligjin ndërsa si rrethana rënduese për secilin prej të akuzuarve gjykata mori shkallën e lartë të pjesëmarrjes së personave të dënuar në veprën penale dhe shkallën e lartë të dashjes të shfaqur nga ana e të akuzuarit sepse nga përshkrimi faktik si dhe provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës del se të akuzuarit veprën penale e kanë kryer me dashje dhe atë direkte ngase e kanë ditur se me veprimet e tyre do të shkaktohet pasoja e ndaluar dhe përkundër kësaj ata e kanë dëshiruar përkatësisht kanë ndërmarrë veprime për shkaktimin e saj ashtu siç përshkruhet në dispozitivin e këtij aktgjykimi gjithashtu si rrethanë rënduese për të akuzuarit gjykata mori edhe këmbëngulësinë e shfaqur nga ana e tyre për kryerjen e veprës penale sepse siç shihet nga përshkrimi faktik po ashtu edhe nga provat e çështjes del se të njëjtë duke e ditur që natën kritike ka qenë i ndaluar qarkullimi i lëvizjes së qytetarëve për shkak të masave anti Covid-19 si dhe asaj që i akuzuari A... herën e parë i kishte ikur policisë në Gjilan të njëjtë pasi takohen me të akuzuarin G... si pronar i veturës sërish nisen në drejtim të qytetit me ç'rast edhe më pas takohen me të dëmtuarit të cilët ia zënë rrugën por të njëjtë të vendosur për të mos respektuar urdhrat e policëve e rrisin shpejtësinë e lëvizjes së veturë aq sa rrezikojnë jetën e të dëmtuarëve dhe nuk u ndalen të njëjtëve, po ashtu si rrethanë rënduese për të akuzuarit gjykata mori edhe faktin se vepra penale e kryer nga ta përfshin disa viktime përkatësisht nga veprimet e të akuzuarve është rrezikuar jeta e 4 të dëmtuarëve andaj duke u bazuar në të lartcekurat gjykata të akuzuarve u shqiptoj dënimin brenda kufijve të paraparë ligjor gjithnjë duke konsideruar se me dënimet e shqiptuara ndaj të tyre mund të arrihen qëllimet e dënimit si në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës të cilat konsistojnë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

6.Vendimi lidhur me llogaritjen e paraburgimit në dënimin e shqiptuar.

Gjykata bazuar në nenin 79 të KPRK-ës të akuzuarit G.H kohën e kaluar nën masën e arrestit shtëpiak nga data 28.11.2020 deri me datë 28.12.2020 ia llogariti në dënimin e shqiptuar me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

7. Vendimi lidhur me kërkesën pasurore juridike.

Gjykata duke u bazuar në nenin 463 paragrafi 1 dhe 2 të KPP-ës të dëmtuarit, E.G, F.K, I. R dhe B. M për realizimin e kërkesës pasurore juridike i udhëzoi në kontest të rregullt juridiko civil.

8.Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Gjykata duke u bazuar në nenin 451 paragrafi 1 të KPP-së, ka vendosur që të akuzuarit ti obligojë secilin veç e veç që të paguajnë paushallin gjyqësor në shumë prej nga 50 € (pesëdhjetë euro) si dhe shumë prej nga 30 € (tridhjetë euro) për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto brenda afatit prej 15 ditëve nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë nën kërcenim të përmbarrimit të dhunshëm.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr.1015/2020 me datë 01.11.2021

Zyrtarja Ligjore,  
gjykues,  
Eronita Llapashtica

Gjyqtari i vetëm

Rilind Sermaxhaj

Numri i lëndës: 2020:166420  
Datë: 01.11.2021  
Numri i dokumentit: 02342208

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimi të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj Gjykate Themelore.